



## KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME SMS, BULK SMS

E lidhur në Prishtinë, më 01.01.2021 ndërmjet:

1. **N.T.SH “KAYALAR”** me zyre qendrore në Shaip Pacolli , Nr.4 Veternik, 10000 Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikues: 811304401 përfaqësuar nga Kevork Arek Findikliyan, Pronar (këtu e më tutje **“Ofruesi i Shërbimit”**). Së bashku referuar si Palët.

dhe

2. \_\_\_\_\_, me zyre qendrore në Prishtinë, Rruga \_\_\_\_\_, Nr.\_\_\_\_, Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikues \_\_\_\_\_ përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ (këtu e më tutje **“Shfrytëzues i Shërbimit”**). Së bashku referuar si Palët.

Palët u morën vesh si më poshtë:

### Neni 1 Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimeve të platformës WEB SMS, apo SMPP (*Short Message Peer-to-Peer*) ku do të mundësoj shfrytëzuesit të shërbimeve dërgimin e SMS-ve palëve të treta apo përdoruesve fundor për nevoja të marketingut. Ofruesi i Shërbimit e ka të drejtën nga ARKEP që për nevojat e shfrytëzuesit të shërbimeve, të bëjë dërgimin të mesazheve të shkurta të çfarëdo lloji, qoftë nga kodet e shkurta të lejuara, apo nga burime tjera, sic janë, por duke mos u limituar në konfirmimet, fjalëkalimet, PIN, mesazhe marketingu, notifikime, qoftë në sasi të vogla apo të larta (Bulk) etj, nëpërmjet infrastrukturës moderne dhe të sigurtë për kryerjen e shërbimeve të marketingut të drejtpërdrejtë nga ana e Ofruesit të Shërbimit tek përdoruesit fundorë.

Për shërbimet e përshkruara më lartë, shfrytëzues i shërbimit është i obliguar që të sigurohet që raportin e tij me përdoruesit fundor, tek numrat e të cilëve do të dërgoj mesazhe, ta mbaj në përputhje të plotë me Ligjin Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë. Tutje, shfrytëzuesi i shërbimit garanton se posedon pëlqimin paraprak të përdoruesve fundorë për pranimin e mesazheve dhe se do t’ia mundësojë të njëjtëve që në çdo kohë t’i garantohet e drejta për të kundërshtuar pranimin e mesazheve të tilla. Pas pranimit të kundërshtimit nga ana e përdoruesit fundor, shfrytëzues i shërbimit, obligohet që brenda 8 ditëve prej pranimit të kundërshtimit të ndalojë dërgimin e mesazheve .

### Neni 2 Çmimi dhe mënyra e pagesës

2.1 Për shërbimet e përshkruara në Nenin 1 të kësaj Marrëveshje, çmimi për SMS me TVSH është :

2.2 Pagesa e faturës do të bëhet më së largu deri me datën 5 të muajit pasues. Ofruesi i shërbimit do t’i ofroj shfrytëzuesit të Shërbimit raportin mujor për mesazhet e gjeneruara.

2.3 Ofruesi i shërbimit mundet, me njoftim paraprak, të pezulloj shërbimet, për shfrytëzuesin i shërbimit në tërësi ose pjesërisht në rast se shfrytëzuesi i Shërbimit dështon të kryej detyrimet në afat të çfarëdo shume ndaj ofruesit të shërbimeve me anë të kësaj kontrate në datën e caktuar të specifikuar në faturë.

### Neni 3 Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet për ndërprerjen e saj



- 3.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi më datë **01.01. 2021** dhe e njëjta do të jetë efektive për një periudhë kohore 1 vjecare, respektivisht deri më **31. 12. 2021**.
- 3.2 Të dy palët mund të ndërpresin këtë kontratë duke lajmëruar paraprakisht me shkrim njëra tjetrën, i cili njoftim duhet të i dërgohet palëve më së paku 15 (pesëmbëdhjete) ditë paraprakisht.
- 3.3 Në rast të shkeljes të ndonjërës prej dispozitave të cekura në dokumentet të cilat përbëjnë këtë kontratë, Palët ruajnë të drejtën të ndërpresin këtë marrëveshje pa paralajmërim paraprak, në qoftë se pala në shkelje nuk merr parasysh vërejtjet e palës tjetër.
- 3.4 Ofruesi i Shërbimit mund të shkëpus kontratën, me paralajmërimin me shkrim dhe pa përmendur arsytet për këtë. Ofruesi i shërbimeve do të ndërpres shërbimin sa më shpejt që teknikisht është e mundur dhe do të konfirmoj këtë me shkrim tek shfytëzuesi i shërbimit.
- 3.5 Ofruesi i shërbimit mund të bej ndryshimin e tarifës së shërbimit, duke lajmëruar paraprakisht Shfytëzuesi I Shërbimit të pakten 30 ditë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve.
- 3.6 Paketat e blera SMS duhet të konsumohen deri më 30 dhjetor të çdo viti.

#### **Neni 4 Obligimet e Shfytëzuesit të Shërbimit**

- 4.1 Shfytëzuesi i Shërbimit duhet të respektoj në përpikëri procedurën e paraparë për marrjen e pëlqimeve me shkrim nga ana e përdoruesve fundorë si dhe të respektoj kushtet e kësaj kontrate në tërësi.
- 4.2 Shfytëzuesit i Shërbimit është i obliguar që t'i marrë të gjitha masat e nevojshme që mesazhi i dërguar tek përdoruesi fundor të mos jetë anonim po të përmbajë të dhënat e dërguesit të mesazhit.
- 4.3 Shfytëzuesit i Shërbimit zotohet se përmbajtja e mesazhit të shkurtë nuk do të ketë përmbajtje e cila mund të fyej përdoruesin fundor, respektivisht përmbajtja e të cilave është e pahijshme, ose e paligjshme apo përmbajtje të dhunshme, fyese, diskriminuese, apo pornografike. Shfytëzuesi i shërbimit duhet të sigurojë që përmbajtja e SMS nuk do të shkaktojë çrregullime apo ngacmim për përdoruesin fundor.
- 4.4 Shfytëzuesi i Shërbimit është i obliguar që shërbimet t'i jap në përputhje të plotë me ligjet e aplikueshme në Kosovë, rregulloret dhe vendimet e ARKEP, rrjedhimisht ofruesi i shërbimit nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj palëve të treta.

#### **Neni 5 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

- 5.1 Ofruesi i shërbimit posedon programin ndërkombëtarë për dërgimin e sms të shkurtë, SMPP (*Short Message Peer-to-Peer*) apo *WEB SMS-in* me të cilën i jep shfytëzuesit të shërbimit shifren dhe fjalëkalimin për tu qasur në linkun për dërgimin e sms-ve që emërtohet: **[kososms.com](http://kososms.com)**. Ky program WEB SMS, apo SMPP, të cilën e jep ofruesi i shërbimit është i licencuar sipas standarteve ndërkombëtare të certifikuar ISO/IEC 27001:2013, për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale.
- 5.2 Shërbimi i ofruar me këtë Kontratë është i varur nga funksioni efektiv i rrjetit të operatorëve të telefonisë mobile të pranuesit të mesazhit, shtirjes së rrjetit të kësaj telefonie, funksionimi i rrjetit të internetit, dhe gjendjes së telefonit mobil të pranuesit të mesazhit.
- 5.3 Ofruesi i shërbimeve zotohet dhe garanton që do të kryej shërbimin duke u bazuar plotësisht në manualin e programit-databazës së ofruesit të shërbimit si dhe kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë.
- 5.4 Ofruesi i shërbimeve garanton dërgesën e mesazhit në destinacionin e caktuar, pa ndonjë vonesë, por jo pranimin e tij. Ofruesi i shërbimeve do të përpiqet maksimalisht që të garantoj kualitetin sipas standardeve më të larta të shërbimeve.
- 5.5 Ofruesi i shërbimeve zotohet dhe garanton se posedon njohuritë e duhura profesionale dhe teknike për ofrimin e shërbimit, sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

#### **Neni 6 - Mbrojtja e të dhënave personale, Masat e sigurisë, E drejta për kundërshtim**

- 6.1 **Mbrojtja e të dhënave personale**- Ofruesi i shërbimit nuk përpunon të dhëna personale. Ofruesi i shërbimit i jep vetëm qasjen shfytëzuesi të shërbimit në WEB SMS apo SMPP, duke i dhënë shifrën dhe fjalëkalimin për tu qasur në linkun për dërgimin e sms-ve që emërtohet: **[kososms.com](http://kososms.com), [kososms.net](http://kososms.net), [kosovosms.com](http://kosovosms.com), pa patur qasjë në këtë link.**



**6.2** Shfrytëzuesi i shërbimit në përputhje të plotë me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 73, i përpunon të dhënat personale të përdoruesve fundorë të saj për qëllime të marketingut të drejtëpërdrejtë të komunikimeve elektronike, që përfshijnë: emër, mbiemër, datëlindja, vendbanimi, numër telefonit, e-mail adresa.

Po ashtu koha, qëllimi, dhe destinimi i përpunimit të të dhënave personale për qëllime të marketingut do të kufizohet vetëm për aq sa do të jetë afati dhe objekti i kësaj kontraktues.

**6.3 Masat e Sigurisë-** Ofruesi i shërbimit garanton shfrytëzuesin e shërbimit dhe të gjithë personat e tretë se posedon programin ndërkombëtarë për dërgimin e sms të shkurtë, SMPP (*Short Message Peer-to-Peer*), se ky WEB SMS është i licencuar sipas standarteve ndërkombëtare të certifikuara ISO/IEC 27001:2013, për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale. Sipas ISO/IEC 27001:2013 siguria e informacionit përcaktohet duke përdorur tre elemente - Konfidencialiteti (informacioni është i disponueshëm vetëm për përdoruesit e autorizuar), Integriteti (informacioni është i plotë dhe i saktë) dhe Disponueshmëria (përdoruesit kanë qasje në informacion kur kërkohet).

**6.4** Ky WEB SMS, të dhënat personale të përsoneve të tretë në mënyrë shumë të sigurtë i ruan në një afat prej 10 vite dhe pas kësaj kohe këto të dhëna personale do të shkatërrohen me automatizim nga vetw sistemi. Gjatë këtij afati 10 vjeçarë në këto të dhëna personale nuk mund të ketë askush qasje me përjashtim personave-subjekteve të autorizuar siq janë: organet shtetërore, Policija, Prokuroria ose Gjykata.

**6.5** Shfrytëzuesi i shërbimit mban përgjegjësi të plotë për informacionin, apo përmbajtjen e të dhënave, të cilat i transmeton dhe i bartë te personat e tretë nëpërmjet qasjes në WEB SMS. Ofruesi i shërbimit nuk mban kurrfarë përgjegjësie për këtë përmbajtje, si edhe as për të dhënat, të cilat shfrytëzuesi i pranon nga palët e treta.

Në pajtim me ligjet në fuqi në Kosovë, Ofruesi i shërbimit do të bashkëpunojë me organe të rendit për kërkesat që këto organe do të kenë lidhur me shërbimin në fjalë që përdor shfrytëzuesi i shërbimit.

**6.6. E drejta për kundërshtim-** Komfor neni 74 të Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, Ofruesi i shërbimit përmes WEB SMS të tij i jep mundësinë të gjithë përdoruesve fundorë apo personave të tretë të paraqesin çfarëdo kërkesë apo ankese me shkrim në lidhje me përdorimin e të dhënave, përmes SMS-it në nr. **55777 ose 55201**, dhe në email adresën: [nukduasms@gmail.com](mailto:nukduasms@gmail.com).

Pas pranimit të kundërshtimit-ankesës nga ana e përdoruesit fundor, ofruesi i shërbimit, obligohet që brenda 8 ditëve prej pranimit të kundërshtimit të ndalojë dërgimin e mesazheve.

### **Njoftimet**

Palët pajtohen që komunikimi në mes të palëve të bëhet në formën e shkruar, në adresat zyrtare të personave përgjegjës: **Ofruesi i shërbimit:** NTSH Kayalar.: Emri dhe Mbiemri: Kevork Arek Findikliyan Telefoni: 045809080 Email: [info@kayalarcallcenter.com](mailto:info@kayalarcallcenter.com);

**Shfrytëzuesi i shërbimit:** \_\_\_\_\_ sh.p.k.: Emri dhe Mbiemri: \_\_\_\_\_  
Telefoni në Zyre: Telefoni Mobil: \_\_\_\_\_ E-mail: \_\_\_\_\_ .com

### **Neni 7 Ruajtja e Konfidencialitetit**

**7.1** Për të eliminuar çdo dyshim, të gjitha informacionet që palët kontraktuese shkëmbejnë në mes vete dhe anasjelltas, do të konsiderohet si sekret tregtar dhe duhet trajtuar në përputhje me kërkesat për ruajtjen e fshehtësisë së tij.

**7.2** Palët pajtohen që asnjë dokument, informacion, apo material, në dispozicion të tyre në kuadrin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë kontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër, të mos bëhet i disponueshëm për palë të treta të paautorizuara.

**7.3** Në rast se ndonjëra prej palëve vlerëson se dhënia apo bërja publike e një informacioni kërkohet prej ligjit ose prej ndonjë autoriteti, informacioni do të ipet, për aq sa lejohet nga ligji dhe për aq sa është e mundur, pas aprovimit nga pala tjetër.



7.4 Pavarësisht kësaj, në rastet kur çfarëdo informate konfidenciale kërkohet të zbulohet nga një gjykatë, prokuroria, policia dhe/apo autoritet tjera përkatëse dhe kompetente, zbulimi i tillë nuk konsiderohet si shkelje e detyrimit për konfidencialitet sipas këtij neni dhe për zbulimin e tillë nuk ka nevojë për pëlqim paraprak, nga pala tjetër.

### **Neni 8 Ligji i aplikueshëm dhe Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**8.1** Kjo marrëveshje do të udhëhiqet dhe interpretohet në pajtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Të gjitha pikat e diskutueshme fillimisht do të tentohet që nga palët kontraktuese të arrihet marrëveshje.

**8.2** Kontestet eventuale në lidhje me kontratë do të jetë objekt shqyrtimi nga të dy palët, nëse nuk mund të gjendet ndonjë zgjidhje e pranueshme për palët brenda 5 ditëve (pesë) ditësh nga paraqitja e mosmarrëveshjes, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

### **Neni 9 Dispozita përfundimtare**

**9.1** Me nënshkrimin e këtij dokumenti shfrytëzuesi i shërbimit vërteton se ka pranuar dhe lexuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ofruesi i shërbimeve, dhe i pranon si të tilla.

**9.2** Kjo Kontratë i shfuqizon të gjitha Marrëveshjet paraprake të lidhura në ndërmjet Palëve për objektin e kësaj kontrate.

**9.3** Kjo Kontratë dhe të gjitha dokumentet përbërëse të kësaj Marrëveshje janë përpiluar në dy (2) kopje identike, nga një për secilën palë dhe e njëjta është shprehje e vullnetit të palëve të cilët me nënshkrimin personal shprehin pajtueshmërinë e kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

**Orfuesi i Shërbimit,**

N.T.SH “KAYALAR”

Drejtori, Kevork Arek Findikliyan

\_\_\_\_\_

**Shrytëzuesi i Shërbimit**

“ \_\_\_\_\_ ”

Drejtori, \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_